



Prishtinë, më 02 dhjetor 2019
Nr. ref.: KK 320/19

Në pajtim me nenet 112.2 dhe 115 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Kushtetuta), nenet 2, 11 dhe 13 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121, rregullat 17 dhe 18 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës 01/2018, pas mbajtjes së seancës administrative më 26 nëntor 2019, miratohet Rregullorja e Njësisë Ligjore të Gjykatës Kushtetuese.

RREGULLORE E NJËSISË LIGJORE Nr. 03/2019

Mbi ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 02/2018

I. Funksionet, organizimi dhe struktura

Neni 1 Dispozitat e përgjithshme

- Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të përcaktojë funksionet, organizimin dhe strukturën e Njësisë Ligjore dhe anëtarëve të saj.
- Me këtë Rregullore përcaktohen: përbërja e Njësisë Ligjore dhe përshkrimi i detyrave të punës të anëtarëve të saj; procedurat e rekrutimit dhe të punës provuese; procedurat e vlerësimit të performancës dhe të avancimit; procedurat disiplinore; procedurat e themelimit dhe shuarjes së marrëdhënieς së punës; dhe të gjitha çështjet tjera lidhur me efikasitetin e Njësisë Ligjore.
- Anëtarët e Njësisë Ligjore nuk janë shërbyes civilë. Anëtarët e Njësisë Ligjore kanë statusin e të punësuarve profesionalë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Gjykata). Statusi juridik i anëtarëve të Njësisë Ligjore nënkupton aplikimin e parimeve bazë të ligjeve në fuqi me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës në Republikën e Kosovës. Aktet burimore për rregullimin e këtij statusi juridik janë: Ligji për Gjykatën Kushtetuese, Rregullorja e punës së Gjykatës si dhe kjo Rregullore.
- Njësia Ligjore mbështetet nga Sekretariati i Gjykatës për sa i përket burimeve teknike, logistike dhe administrative që ndërlidhen me funksionimin efikas dhe efektiv të Njësisë Ligjore.

Neni 2 **Funkzionet e Njësisë Ligjore**

1. Njësia Ligjore është strukturë organizative e veçantë në Gjykatë, e cila i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit të Gjykatës (Kryetari). Kryetari lidhur me ushtrimin e përgjegjësive të anëtarëve të Njësisë Ligjore njofton gjyqtarët e Gjykatës.
2. Njësia Ligjore kryen detyrat e saj në mbështetje të punës profesionale të gjyqtarëve, duke bërë hulumtime dhe analiza ligjore dhe duke ndihmuar në hartimin e raporteve paraprake, vendimeve si dhe materialit tjetër ligjor në mbështetje të punës së gjyqtarëve të Gjykatës dhe detyra të tjera relevante të caktuara.
3. Njësia Ligjore asiston në pranimin e kërkesave dhe dokumenteve tjera duke kontrolluar formularin e kërkesës, dhe duke vlerësuar nëse nevojitet ndonjë plotësim apo sqarim, në bashkërendim me Departamentin për Regjistrim të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv (në tekstin e mëtejmë: DRLSA) dhe Sekretariatin.
4. Njësia Ligjore filtron kërkesat e reja të dorëzuara në Gjykatë dhe harton reportin në bazë të formës standarde të miratuar nga Kryetari.
5. Njësia Ligjore hulumton legjislacionin, autoritetet juridike, jurisprudencën dhe aspektet tjera kushtetuese dhe ligjore që ndërlidhen me rastet që janë objekt i shqyrtimit në Gjykatë, në bashkërendim me gjyqtarin raportues, gjyqtarin kryesues të Kolegit shqyrtues, Gjykatën dhe Kryetarin.
6. Njësia Ligjore identifikon kërkesat për masa të përkohshme dhe informon Kryetarin.

Neni 3 **Përbërja, udhëheqja dhe pagat**

1. Njësia Ligjore përbëhet nga:
 - Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik;
 - Juristkonsulti;
 - Zëvendës Këshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë;
 - Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët Kushtetues Juridikë;
 - Këshilltari i Lartë për Administrimin e Kërkesave;
 - Sekretarët Kushtetues Juridikë.
2. Gjyqtarët, me shumicë votash, caktojnë një nga Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë si Këshilltarë të Parë Kushtetues Juridikë dhe dy Zëvendës Këshilltarë të Parë Kushtetues Juridikë për një periudhë 3 (tri) vjeçare. Gjyqtarët, me procedurë të njëjtë, me shumicë votash, caktojnë një nga Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë si Juristkonsult. Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik, Juristkonsulti, dhe Zëvendëskëshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë mund të largohen nga detyra në çdo kohë me shumicë votash të gjyqtarëve.

3. Pagat e anëtarëve të Njësisë Ligjore përcaktohen me vendim të gjyqtarëve.
4. Paga e Këshilltarit të Parë Kushtetues Juridik do të rritet për 10% gjatë mandatit të tij/saj. Paga e Zëvendëskëshilltarit të Parë Kushtetues Juridik do të rritet për 5% gjatë mandatit të tij/saj. Paga e Juristkonsultit do të jetë ekuivalente me pagën e Këshilltarit të Parë Kushtetues Juridik.

Neni 4
Funksionet e Këshilltarit të Parë Kushtetues
Juridik/Zëvendëskëshilltarëve të Parë Kushtetues Juridikë

1. Këshilltari i Parë Juridik Kushtetues udhëheqë dhe mbikëqyr Njësinë Ligjore. Në mungesë të Këshilltarit të Parë Kushtetues Juridik, detyrat e tij i kryen Zëvendëskëshilltari i Parë Kushtetues Juridik.
2. Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik i raporton drejtpërdrejt Kryetarit të Gjykatës.
3. Këshilltari i Parë Juridik Kushtetues kryen funksionet si në vijim:
 - a) ndihmon dhe këshillon Gjykatën në kryerjen e funksioneve të saj;
 - b) mbështetë anëtarët e Njësisë Ligjore në kryerjen e detyrave të tyre;
 - c) shërben si ndërlidhës për të gjitha komunikimet në lidhje me kërkesat e Gjykatës në bashkërendim me Drejtorin e DRLSA-së dhe Sekretariatin;
 - d) mbikëqyr organizimin, aktivitetet dhe performancën e anëtarëve të Njësisë Ligjore;
 - e) merr pjesë në të gjitha seancat e Gjykatës;
 - f) ndan kërkesat në mënyrë proporcionale, duke marrë parasysh kompleksitetin, nivelin e vështirësisë dhe rëndësinë e kërkesës, për të gjithë anëtarët e Njësisë Ligjore, në këshillim me Kryetarin; siguron dhënien e përparësisë të shqyrtimit të lëndëve, sipas Regullores së punës dhe udhëzimeve të Kryetarit;
 - g) ndan detyra të tjera specifike për anëtarët e Njësisë Ligjore;
 - h) mbikëqyr anëtarët e Njësisë Ligjore në procesin e përgatitjes së raporteve paraprake, vendimeve finale dhe dokumenteve të tjera ligjore duke siguruar kualitet të lartë të aplikimit të standardeve të kërkimit shteres ligjor në nivel të së drejtës kombëtare të Republikës së Kosovës; të drejtës kushtetuese rajonale dhe ndërkombëtare; të drejtës ndërkombëtare dhe asaj krahasuese; opinioneve, rekomandimeve dhe praktikave të mira të shpallura nën ombrellën e Këshillit të Evropës dhe Komisionit të Venecias; praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; dhe, sipas nevojës, edhe të gjykatave të tjera ndërkombëtare;
 - i) mbikëqyr procesin e sigurimit të kualitetit dhe konsistencës së vendimmarrjes në Gjykatë;
 - j) siguron që anëtarët e rinj të Njësisë Ligjore kanë mbikëqyrje të veçantë në përshtatjen me kryerjen e detyrave të tyre;
 - k) bën vlerësimin paraprak të performancës së të gjithë anëtarëve të Njësisë Ligjore në baza vjetore.

Neni 5 **Funksionet e Juristkonsultit**

1. Juristkonsulti kryen funksionet si në vijim:
 - a) këshillon Gjykatën dhe e njofton atë për çështje të ndryshme që ndërlidhen me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe konsistencën e asaj praktike gjyqësore;
 - b) këshillon Gjykatën dhe e njofton atë në baza 3 (tre) mujore lidhur me praktikën e re gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo për praktika të reja gjyqësore të shteteve anëtare të Komisionit të Venecias;
 - c) siguron konsistencën e praktikës gjyqësore të Gjykatës, duke këshilluar Gjykatën dhe duke e njoftuar atë lidhur me ndjekjen e praktikës gjyqësore të deritanishme në raste specifike dhe vë në pah rastet në të cilat po krijohet praktikë e re gjyqësore; rastet me të cilat mund të ndryshohet praktika ekzistuese gjyqësore; apo, rastet për të cilat po vendoset një standard për herë të parë në praktikën gjyqësore të Gjykatës;
 - d) monitoron, në bashkërendim me Këshilltarin e Parë Kushtetues Ligjor, përbajtjen e të gjitha draft-vendimeve të propozuara të Gjykatës (Aktgjykimeve, Aktvendimeve dhe Vendimeve) me qëllim të sigurimit të kualitetit të lartë të vendimmarrjes dhe konsistencës së praktikës gjyqësore; dhe, në këtë aspekt, propozon rekomandime përkatëse të cilat kanë për synim konsistencën dhe kualitetin e vendimmarrjes së Gjykatës;
 - e) propozon, në bashkërendim me Këshilltarin e Parë Kushtetues Ligjor, hartimin e drafteve-standarde (“templates”) për sigurim të konsistencës së praktikës gjyqësore;
 - f) propozon literaturë të re juridike, raste të reja për studim, vendime të reja me qëllim të shpërndarjes së njohurive të reja tek të gjithë anëtarët e Njësisë Ligjore;
 - g) kryen detyra të tjera që ndërlidhen me konsistencën e praktikës gjyqësore, sipas nevojës.

2. Kushtet për t'u zgjedhur Juristkonsult:

- a) Kandidati për Juristkonsult duhet të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë profesionale në Gjykatën Kushtetuese si Këshilltar i Lartë Kushtetues Juridik.

Neni 6 **Funksionet e Këshilltarëve të Lartë Kushtetues Juridikë**

1. Këshilltari i Lartë Kushtetues Juridik kryen funksionet si në vijim:
 - a) ndihmon në përgatitjen e raporteve paraprake, vendimeve dhe materialeve të tjera ligjore që ndërlidhen me juridiksionin e Gjykatës;
 - b) bën analiza kushtetuese dhe ligjore;
 - c) merr pjesë në seanca shqyrtyuese dhe mban shënimë për rastet;
 - d) përgatitë opinione kushtetuese-ligjore sipas kërkesave të Kryetarit apo gjyqtarëve të Gjykatës;

- e) monitoron dhe udhëzon Këshilltarët Kushtetues Juridikë lidhur me detyrat që u janë caktuar atyre në rastet;
- f) kontribuon në funksionimin efikas dhe efektiv të Njësisë Ligjore si dhe kryen detyra tjera që kërkohej nga Këshilltar i Parë Kushtetues Juridik;
- g) përgjegjës për të siguruar kualitetin e vendimeve të Gjykatës në rastet në të cilat janë caktuar; dhe
- h) përgjegjës për të mbështetë hulumtimin, analizën dhe hartimin e mendimeve mospajtuese dhe konkurruese sipas këshillës së gjyqtarit.

2. Kushtet për t'u zgjedhur Këshilltar i Lartë Kushtetues Juridik janë:

- a) Përgatitja e avancuar universitare në shkencat juridike, me ekspertizë në të drejtën publike, të drejtën kushtetuese, të drejtësisë kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut;
- b) Pesë (5) vite përvojë profesionale juridike;
- c) Njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze.

Neni 7 Funksionet e Këshilltarëve Kushtetues Juridikë

1. Këshilltar Kushtetues Juridik kryen funksionet si në vijim:

- a) mbështetë punën e Këshilltarëve të Lartë Kushtetues Juridikë;
- b) hulumton dhe studion literaturë përkatëse kushtetuese-ligjore të nivelit vendor dhe ndërkombëtar;
- c) hulumton dhe kërkon informacion të nevojshëm, *inter alia*, të vendimeve të gjykatave të tjera kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- d) përgatitë analiza krahasuese në bashkërendim me Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë;
- e) kontribuon në funksionimin efektiv dhe efikas të Njësisë Ligjore si dhe kryen punë tjera që kërkohej nga Këshilltar i Parë Kushtetues Juridik.

2. Këshilltarëve Kushtetues Juridikë mund t'i caktohen raste pas kalimit të punës provuese dhe konfirmimit të kontratës së punës. Këshilltarët Kushtetues Juridikë mund të avancohen në pozitën e Këshilltarit të Lartë Kushtetues Juridik pas propozimit të gjyqtarëve, Kryetarit apo Këshilltarit të Parë Kushtetues Juridik.

3. Kushtet për t'u zgjedhur Këshilltar Kushtetues Juridik janë:

- a) përgatitja universitare në shkencat juridike, preferohet ekspertizë në të drejtën publike, të drejtën kushtetuese, të drejtësisë kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut;
- b) tri (3) vite përvojë profesionale juridike;
- c) njohuritë e shkëlqyeshme të gjuhës angleze.

Neni 8 **Funkzionet e Këshilltarit të Lartë për Administrim të Kërkesave**

1. Këshilltari i Lartë për Administrimin e Kërkesave kryen funksionet si në vijim:
 - a) zhvillon takime me parashtruesit e kërkesave;
 - b) kontrollon dokumentacionin e paraqitur në kërkesë dhe udhëzon parashtruesit për plotësimet e nevojshme;
 - c) përgatitë dhe plotëson formularin standard të filtrimit për kërkesat e regjistruara;
 - d) jep sugjerime (indikacione) për ndjeshmërinë e rastit të pranuar në Gjykatë;
 - e) përgatit raportin favor për Kryetarin e Gjykatës lidhur me kërkesat e arritura brenda javës;
 - f) raporton në Njësinë Ligjore lidhur me numrin dhe natyrën e rasteve të pranuara në Gjykatë;
 - g) përpilon procesverbalin për këshillim e votim;
 - h) përgatitë raporte të veçanta për nevoja të Njësisë Ligjore;
 - i) përgatit raportin për përbushjen e kritereve pasi të jetë gati vendimi për publikim;
 - j) plotëson dhe përditëson statistikat e rasteve në folderin e Njësisë Ligjore;
 - k) mirëmban dhe përditëson databazën e Gjykatës për monitorimin e zbatimit të vendimeve të Gjykatës;
 - l) kryen edhe detyra të tjera me kërkesë të Këshilltarit të Parë Kushtetues Juridik.
2. Kushtet për t'u zgjedhur Këshilltar i Lartë për Administrim të Kërkesave janë:
 - a) përgatitja universitare në shkencat juridike;
 - b) pesë (5) vite përvojë profesionale juridike;
 - c) njohuri të gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës dhe gjuhës angleze.

Neni 9 **Funkzionet e Sekretarit Kushtetues Juridik**

1. Sekretari Kushtetues Juridik kryen funksionet si në vijim:
 - a) mbështet punën e Këshilltarëve të Lartë Kushtetues Juridikë dhe Këshilltarëve Kushtetues Juridikë;
 - b) përpilon njoftime standarde menjëherë pas regjistrimit të një kërkese të re;
 - c) përpilon kërkesa për dokumente shtesë, në bazë të kërkesave të Këshilltarëve të Lartë Kushtetues Juridikë dhe Këshilltarëve Kushtetues Juridikë;
 - d) procedon për përkthim të gjitha shkresat e përpiluara si dhe i procedon ato në DRLSA për procedim të mëtutjeshëm;
 - e) përcjell rastet deri në vendosje dhe publikim.
 - f) asiston dhe ndihmon Këshilltarin e Parë Kushtetues Juridik në takimet e Njësisë Ligjore dhe të seancave të Gjykatës;
 - g) përpilon vendime përkatëse lidhur me vendimet e marra në seanca shqyrtyuese të Gjykatës;

- h) kontribuon në funksionimin efikas të Njësisë Ligjore si dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik.
2. Kushtet për t'u zgjedhur Sekretar Kushtetues Juridik janë:

- a) Përgatitja universitare në shkencat juridike;
- b) Dy (2) vite përvojë profesionale juridike;
- c) Njohuritë të mira të gjuhës angleze.

Neni 10 Ndarja e kërkesave

1. Sapo të jetë regjistruar një kërkesë dhe të jetë caktuar gjyqtari raportues, Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik cakton një Këshilltar të Lartë Kushtetues Juridik apo Këshilltar Kushtetues Juridik për të asistuar gjyqtarin raportues.
2. Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik vlerëson nëse rasti është i asaj natyre që kërkon angazhim të më shumë Këshilltarëve, në konsultim me Kryetarin cakton Këshilltarët e nevojshëm për rastin konkret.
3. Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik siguron që kërkesat të ndahen në mënyrë të balancuar dhe proporcionale tek të gjithë Këshilltarët.
4. Këshilltarët për aq sa është e mundur do të caktohen proporcionalisht edhe në kërkesat me të gjithë gjyqtarët raportues.
5. Këshilltarët kanë të drejtë të plotë të paraqesin mendimin e tyre profesional lidhur me kërkesën, për çka ata nuk mund të merren në përgjegjësi disiplinore.
6. Për çfarëdo konflikti interes i lidhje me kërkesën, Këshilltarët lajmërojnë Këshilltarin e Parë Kushtetues Juridik në momentin e parë të paraqitjes së atij konflikti. Këshilltari mund të kërkojë përjashtimin e tij nga rasti edhe për arsyet e tjerë të justifikueshme. Për përjashtimin eventual vendos Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik në bashkërendim me Kryetarin.

II. Procedura e Rekrutimit

Neni 11 Rekrutimi

Rekrutimi i anëtarëve të Njësisë Ligjore bëhet në përputhje me nevojat e Gjykatës. Numri i anëtarëve të Njësisë Ligjore përcaktohet nga gjyqtarët.

Neni 12 Fillimi i rekrutimit

1. Kërkesa për rekrutim së bashku me përshkrimin e detyrave të punës, i dorëzohet Kryetarit nga ana e Këshilltarit të Parë Kushtetues Juridik.

- Rekrutimi për plotësimin e pozitave të lira, ose për plotësimin e pozitave të reja shpallet në mënyrë publike.
- Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore (DABNJ) është përgjegjës për publikimin e konkursit të rekrutimit. Përbajtja e shpalljeve publike përcaktohet në përputhje me përshkrimin e punës.

Neni 13
Komisioni përzgjedhës

- Kryetari themelon një Komision Përzgjedhës (Komisioni), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit dhe të përzgjedhjes përfundimtare.
- Komisioni përbëhet nga 3 (tre) gjyqtarë. Kryesuesi i Komisionit mbikëqyr procedurat dhe asistohet nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik.
- Komisioni shqyrton aplikacionet, kryen vlerësimin dhe përgatitë listën e ngushtë të kandidatëve. Kandidatët të cilët janë në listën e ngushtë ftohen në test me shkrim. Pas vlerësimit të testit me shkrim, Komisioni përpilon listën e kandidatëve që ftohen në intervistë me gojë.

Neni 14
Testi me shkrim dhe me gojë

- Komisioni do të përgatitë testin me shkrim dhe me gojë për kandidatë, duke parashikuar të vlerësojë njohuritë, arsyetimin dhe aftësitë e hartimit të kandidatit, dhe përvojën, kuptimin e sistemit kushtetues dhe motivimin për pozitë.
- Testi me shkrim përmban 5 (pesë) pyetje, prej të cilave 1 (një) ese dhe 4 (katër) pyetje lidhur me njohuritë specifike të kërkuarë për pozitën e shpallur. Njëra nga pyetjet dhe përgjigja përkatëse është në gjuhën angleze.
- Komisioni përzgjedhës në testin me shkrim vlerëson:
 - esenë me 0-30 pikë;
 - secilën nga tri pyetjet me 0 - 15 pikë;
 - pyetjen në gjuhën e huaj (angleze ose ndonjë gjuhë tjetër të huaj) me 0 - 25 pikë.
- Testi me gojë bëhet nga i njëjti Komision, i cili parashtron 3 (tri) pyetje. Komisioni vlerëson secilën prej përgjigjeve me 0 - 33 pikë.
- Anëtarët e Komisionit shënojnë vlerësimin e kandidatëve në formularin e përgatitur më parë për këtë procedurë.
- Pas përfundimit të testimeve me shkrim dhe me gojë, kryesuesi i Komisionit do të përgatitë për Kryetarin një raport të shkurtër me shkrim, duke bashkëngjitur format përkatëse dhe duke propozuar emërimin e kandidatit të suksesshëm.

Neni 15
Procedurat e Ankimit

1. Një Komision i ankesave i themeluar nga Kryetari shqyrton ankesat e dorëzuara nga kandidatët kundër vendimit përfundimtar të Komisionit.
2. Komisioni i ankesave përbëhet nga 3 (tre) gjyqtarë, të cilët nuk kanë qenë anëtarë të Komisionit Përzgjedhës.
3. Komisioni i ankesave nxjerr vendimin lidhur me ankesën në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e ankesës.

III. Themelimi i Marrëdhënies së Punës

Neni 16
Kushtet dhe kriteret për themelin e marrëdhënies së punës

1. Kandidatët e suksesshëm lidhin kontratë të punës me Gjykatën, pasi që të marrin miratimin e gjyqtarëve.
2. Kontrata e punës lidhet për kohë të pacaktuar, dhe konfirmohet pas përfundimit me sukses të periudhës provuese.

Neni 17
Përbajtja e Kontratës së Punës

1. Kontrata e Punës përmban:
 - a) të dhënat për punëdhënësin (Gjykatën);
 - b) të dhënat për të punësuarin (emri, mbiemri, kualifikimi dhe vendbanimi);
 - c) emërtimin, natyrën, llojin e punës dhe përshkrimin e detyrave të punës;
 - d) vendin e punës;
 - e) orët dhe orarin e punës;
 - f) datën e fillimit të punës;
 - g) kohëzgjatjen e Kontratës së Punës;
 - h) lartësinë e pagës bruto si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër;
 - i) kohëzgjatjen e pushimeve;
 - j) përfundimin e marrëdhënies së punës; dhe
 - k) të dhëna të tjera për të cilat punëdhënësi dhe i punësuari i vlerësojnë të rëndësishme për rregullimin e marrëdhënies së punës;
2. Anëtarët e Njësisë Ligjore kanë të drejtë në 20 (njëzet) ditë pushim vjetor. Çdo 3 (tri) vite pune të rregullt anëtarëve të Njësisë Ligjore do t'i u shtohet nga 1 (një) ditë në pushimin vjetor të tyre.
3. Të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë të përcaktuara me kontratën e punës dhe me këtë Rregullore rregullohen në bazë të parimeve të përgjithshme të ligjeve në fuqi, për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë funksionale, organizative dhe financiare të Gjykatës siç garantohet me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

IV. Vlerësimi i performancës

Neni 18 Ndikimi i vlerësimit

1. Vlerësimi i performancës ndikon në përcaktimin e:
 - a) përshtatshmërisë për avancim;
 - b) nevojave për trajnim; dhe
 - c) vazhdimit ose ndërprerjes së marrëdhënies së punës.
2. Vlerësimi është gjithashtu relevant për procedurat disiplinore.

Neni 19 Baza e vlerësimit

Vlerësimi i performancës së anëtarëve të Njësisë Ligjore bazohet në cilësinë e punës, sasinë e punës, njohjen e punës, aftësitë ndërpersonale dhe punën në grup, pavarësinë dhe fleksibilitetin, punën nën presion, komunikimin me shkrim dhe me gojë, aftësitë kompjuterike dhe aspekte të tjera (konfidencialiteti, integriteti).

Neni 20 Sistemi i vlerësimit

1. Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik dhe Juristkonsulti vlerësohen nga Kryetari, duke marrë parasysh mendimet e gjyqtarëve.
2. Zëvendëskëshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë, Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë dhe Këshilltari Kushtetues Juridik vlerësohen nga një raport paraprak vlerësimi i performancës nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik.
3. Vlerësimi i bërë nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik vërtetohet nga Kryetari.
4. Këshilltari i Lartë për Administrimin e Kërkesave dhe Sekretari Kushtetues Juridik vlerësohen nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik. Vlerësimi i bërë nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik vërtetohet nga Kryetari.

Neni 21 Periudha e vlerësimit

Vlerësimi i punës së anëtarëve të Njësisë Ligjore bëhet çdo 1 (një) vit. Vlerësimi përfshin periudhën kohore nga 1 janari deri më 31 dhjetor.

Neni 22 **Procedura e vlerësimit**

1. Procedura e vlerësimit të performancës së anëtarëve të Njësisë Ligjore realizohet përmes formularit të vlerësimit i cili është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje. Formulari i vlerësimit:
 - a) për Këshilltarin e Parë Kushtetues Juridik dhe Juristkonsultin përmban pjesën e mendimit të gjyqtarëve si dhe konfirmimin përfundimtar nga Kryetari;
 - b) për Zëvendëskëshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë, Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë dhe Këshilltarët Kushtetues Juridikë përmban vlerësimin nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik, mendimin e gjyqtarëve dhe konfirmimin përfundimtar nga Kryetari;
 - c) për Këshilltarin e Lartë për Administrimin e Kërkesave dhe Sekretarin Kushtetues Juridik përmban vlerësimin nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik, dhe konfirmimin nga Kryetari.
2. Procedura e vlerësimit përfshin:
 - a) Vlerësimin paraprak të anëtarit të Njësisë Ligjore, nga Kryetari gjegjësisht nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik, përmes formularit të vlerësimit i cili i dorëzohet anëtarit përkatës;
 - b) Mbajtjen e takimit me anëtarin përkatës të Njësisë Ligjore me qëllim të diskutimit të vlerësimit paraprak;
 - c) Në rast të pajtimit, formulari i vlerësimit nënshkruhet nga vlerësuesi dhe i vlerësuari;
 - d) Në rast të mospajtimit, anëtari i vlerësuar i Njësisë Ligjore mund t'i paraqes vërejtjet e tij me shkrim dhe të kërkoj mbajtjen e një takimi me Kryetarin me qëllim të diskutimit të vlerësimit përfundimtar;
 - e) Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik i dërgon formularët e plotësuar dhe të nënshkruar, të secilit anëtar të Njësisë Ligjore, për arkivim te DABNJ brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të formularëve.

Neni 23 **Raportet e performancës**

1. Raporti i performancës 6 (gjashtë) mujore i dorëzohet Këshilltarit të Parë Kushtetues Juridik, i cili aprovon më pas atë pasi saktësia e tij të jetë vërtetuar.
2. Raporti standard i performancës do të hartohet nga Njësia Ligjore dhe i dorëzohet Kryetarit për miratim.

Neni 24 Ankesa

Anëtarët e Njësisë Ligjore, në rast të mospajtimit me vlerësimin e bërë, kanë të drejtë ankese në Komisionin e Ankesave në pajtim me nenet e kësaj Rregulloreje.

Neni 25 Regjistrimi i raporteve për vlerësim të performancës

1. Rezultatet e vlerësimit të performancës vendosen dhe ruhen në dosjen e personelit në DABNJ.
2. Anëtarët e Njësisë Ligjore kanë qasje të pakufizuar ndaj vlerësimit të raporteve të performancës së tyre dhe opinionet e tyre mund t'i dorëzojnë në dosjet që arkivohen në DABNJ.
3. Anëtarët e Njësisë Ligjore mund t'i përdorin raportet e vlerësimit të punës për nevojat e tyre personale.

V. Procedurat e avancimit

Neni 26 Procedurat e avancimit

1. Numri i anëtarëve të Njësisë Ligjore nga secili nivel i përbërjes së tij përcaktohet me vendim të gjyqtarëve.
2. Procedurat e avancimit do të jenë në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Ligjit dhe përcaktohen si në vijim:
 - a) Një Këshilltar Kushtetues Juridik, mund të avancohet në pozitën e Këshilltarit të Lartë Kushtetues Juridik vetëm pas 2 (dy) vjetësh punë në pozitën e Këshilltarit Kushtetues Juridik dhe nëse ka konkurs për atë pozitë. Në këtë periudhë kohore llogaritet edhe periudha e punës provuese.
 - b) Gjykata bën një shpallje të brendshme të konkursit për avancim në pozitën e Këshilltarit Kushtetues Juridik. Shpallja bëhet në tabelën e shpalljeve, në mjetet e brendshme elektronike (monitorët në vende publike të Gjykatës) dhe një kopje ua ka shpërndarë të gjithë anëtarëve të Njësisë Ligjore nëpërmjet postës elektronike.
 - c) Një komision, i përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë dhe i caktuar nga Kryetari, shqyrton aplikacionet dhe interviston kandidatët për avancim në pozitë.
 - d) Kriteret për intervistim (me shkrim/me gojë) dhe për vlerësim përcaktohen si në vijim:
 - kandidatit i parashtrohen 5 (pesë) pyetje, prej të cilave 3 (tri) në gjuhën shqipe, serbe, dhe 2 (dy) në gjuhën angleze,
 - një (1) pyetje nga fusha e njohurive të përgjithshme;
 - dy (2) pyetje nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe lidhur me punën e përgjithshme në Gjykatë;

- dy (2) pyetje nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
3. Komisioni vlerëson pesë përgjigjet me maksimum 20 pikë për secilën, dhe për rezultatin e arritur së bashku me rekomandimin për avancim njofton kandidatët në afatin prej 7 (shtatë) ditësh, prej datës së intervistimit.
 4. Kandidatët që kanë kaluar testin për avancim në pozitë emërohen në pozitën e Këshilltarëve të Lartë Kushtetues Juridikë, me të gjitha të drejtat, obligimet dhe privilegjet e punës që i gëzojnë Këshilltarët e tjerë të Lartë Kushtetues Juridikë.
 5. Kandidati që nuk ka kaluar intervistën me sukses, ka të drejtë të shikojë dosjen e plotë (duke i mbajtur konfidencial emrat e anëtarëve të Komisionit vlerësues, por duke iu treguar vetëm rezultatet) lidhur me intervistimin të cilit i është nënshtruar.
 6. Kandidati që nuk ka kaluar intervistën aplikon në procedurën e sërishme të avancimit të iniciuar nga Gjykata.
 7. Sekretarët Kushtetues Juridikë të Njësisë Ligjore brenda Njësisë Ligjore, përshtatshmërisht me kriteret e këtij nenit, mund të konkurrojnë për avancim në të gjitha pozitat e parapara brenda Njësisë Ligjore.

VI. Procedurat disiplinore

Neni 27 Shkeljet disiplinore

Shkeljet disiplinore ndahan në shkelje të lehta dhe në shkelje të rënda disiplinore.

Neni 28 Shkeljet e lehta disiplinore

Shkeljet e lehta disiplinore konsiderohen:

- a) mungesat e palajmëruara në punë për një periudhë të shkurtër kohore;
- b) mosrespektimi i orarit të punës.

Neni 29 Shkeljet e rënda disiplinore

1. Shkeljet e rënda disiplinore konsiderohen:

- a) shkeljet e kodit të mirësjelljes për gjyqtarë, për aq sa ato janë të zbatueshme, dhe nëse sjellja e tillë ka ndikuar thellësisht në përgjegjësinë, pavarësinë, paanshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e Gjykatës;
- b) shkelja e detyrave të punës që kanë pasoja në përgjegjësitë, pavarësinë, paanshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e Gjykatës;

- c) sjellja apo kërcënimi që u pamundëson, i pengon apo ua vështirëson të tjerëve kryerjen me sukses të detyrave zyrtare të punës;
 - d) dëmtimi me paramendim i pronës Gjykatës; ose
 - e) dështimi i deklarimit dhe dhënia e deklaratës së rrejshme në lidhje me konfliktin e interesit.
2. Në rast të përsëritjes së shkeljeve të lehta disiplinore sipas nenit 27, më tepër se 2 (dy) herë brenda 1 (një) viti, sjellja konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore.

Neni 30 **Masat disiplinore për shkelje të lehta**

1. Masat disiplinore në vijim mund të shqiptohen për shkelje të lehta disiplinore:
 - a) vërejtje me gojë; ose
 - b) vërejtje me shkrim e cila vendoset në dosjen personale;
2. Shqiptimi i masave të lehta disiplinore bëhet nga Kryetari pas informatave të marra nga gjyqtarët, Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik, apo në ndonjë mënyrë tjetër.
3. Nëse Kryetari, pas pranimit të njoftimit për masa disiplinore, konsideron se shkeljet e tillë përbëjnë shkelje të rënda disiplinore, rasti do t'i përcillet Komisionit Disiplinor të themeluar nga Kryetari.
4. Masat disiplinore të shqiptuara për shkelje të lehta disiplinore shqiptohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data kur ka ndodhur shkelja disiplinore por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga ajo datë.
5. Vërejtja me shkrim fshihet nga dosja pasi të ketë kaluar 1 (një) vit nga shqiptimi i masës disiplinore me kusht që të mos përsëritet.
6. Anëtari i Njësisë Ligjore ka të drejtë ankesë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i vërejtjes me shkrim. Vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar.

Neni 31 **Masat disiplinore për shkelje të rënda**

1. Masat në vijim mund të shqiptohen për shkelje të rënda disiplinore:
 - a) pezullim i ushtrimit të detyrave të punës dhe zvogëlim i 30% të rrogës për një periudhë deri në 3 (tre) muaj, varësish nga pasojat e shkaktuara nga shkelja disiplinore;
 - b) ushtrimi i kufizuar detyrave të punës;
 - c) ndalimi i avancimit për një periudhë deri në 5 (pesë) vite;
 - d) ndërprerja e marrëdhënies së punës.
2. Masat disiplinore për shkelje të rënda disiplinore shqiptohen nga Komisioni Disiplinor.

3. Inicimi i procedurës për shkelje të rënda disiplinore bëhet me shkrim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita kur ka ndodhur shkelja, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj.
4. Para se të merret vendimi nga Komisioni Disiplinor, anëtari i Njësisë Ligjore ka të drejtë të paraqesë dëshmi dhe të dëgjohet para Komisionit.

Neni 32
Pezullimi Parandalues

1. Anëtari i Njësisë Ligjore mund të pezullohet nga puna me pagesë deri në marrjen e vendimit për shkelje të rëndë disiplinore, por jo më gjatë se 3 (tre) muaj.
2. Anëtari i Njësisë Ligjore, mund të pezullohet nga puna me pagesë $\frac{1}{2}$ e pagës në rast se ndaj tij ka filluar procedura penale ndërsa mund të pezullohet pa të drejtë pagesë nëse akuzohet për kryerje të veprës penale si pasojë e kryerjes ose moskryerjes së detyrave të punës.
3. Nëse pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, anëtari i Njësisë Ligjore nuk dënohet për kryerje të veprës penale për të cilën akuzohet, ka të drejtë në rikthim në punë.

Neni 33
Vendimi përfundimtar për shkelje të rënda disiplinore

1. Për vendimin përfundimtar për përfundim të marrëdhënies së punës me Gjykatën njoftohet në seancë administrative.
2. Anëtari i Njësisë Ligjore ka të drejtë të iniciojë procedurë në gjykatën kompetente ndaj vendimit përfundimtar në lidhje me shkarkimin.,

VII. Përfundimi i Marrëdhënies së Punës

Neni 34
Përfundimi i marrëdhënies së punës

1. Marrëdhënia e punës në Gjykatë përfundon në rast të:
 - a) dorëheqjes; ose
 - b) moskonfirmimit të punës provuese; ose
 - c) shkarkimit.

Neni 35
Dorëheqja

1. Anëtarët e Njësisë Ligjore mund të japid dorëheqje nga pozita duke njoftuar Kryetarin të paktën 30 (tridhjetë) ditë më herët.

2. Gjatë periudhës provuese anëtar i Njësisë Ligjore mund të japë dorëheqje duke njoftuar Kryetarin, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë më herët.

Neni 36 **Moskonfirmimi pas periudhës provuese**

1. Pas periudhës provuese prej 1 (një) viti, një panel i përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë, vlerëson raportin e periudhës provuese të dorëzuar nga Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik dhe vendosë për konfirmimin e pozitës përfundimtar të pacaktuar.
2. Në rast të moskonfirmimit të marrëdhënies së punës pas periudhës provuese, Këshilltari Kushtetues Juridik mund të ndjekë procedurat e brendshme ankimore të parapara me këtë Rregullore.
3. Këshilltari Kushtetues Juridik ka të drejtë të iniciojë procedurë në gjykatën kompetente sipas legjislacionit në fuqi ndaj vendimit përfundimtar të Gjykatës përfundimtar të pozitës pas periudhës provuese.

Neni 37 **Shkarkimi**

Shkarkimi i Këshilltarëve Kushtetues Juridikë mund të shqiptohet vetëm për shkelje të rënda disiplinore të parapara në Kapitullin VI të kësaj Rregulloreje dhe sipas procedurave të parashikuara në këtë Rregullore.

Neni 38 **Dispozitat kalimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të plotësim-ndryshimeve të Rregullores nr. 02/2018 të 31 majit 2018, do të krijohet një version i ri dhe i spastruar i kësaj Rregulloreje me numërim përkatës të të gjitha neneve sipas radhës. Të gjitha ndryshimet do të ruhen dhe arkivohen në Gjykatë.
2. Me hyrjen në fuqi të këtyre plotësim-ndryshimeve shfuqizohen të gjitha dispozitat e tjera të akteve të brendshme të Gjykatës të cilat bien ndesh me këtë Rregullore.

Neni 39 **Hyrja në fuqi**

Plotësim-ndryshimet e kësaj Rregulloreje hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja.

Prishtinë, më 02 dhjetor 2019



Kryetare e Gjykatës Kushtetuese